

Dr. Shefqet Krasniqi

Nuk është hera e parë që sllavo-maqedonasit provokojnë shqiptarët dhe atë jo vetëm mbi baza etnike.

Fyerja e shqiptarëve sikur është bërë zakon në 'kulturën' maqedonase. Jo rrallë evenimentet e tyre kulturore kalojnë në ceremoni djallëzore. Dhe, më e keqja, ata jo vetëm që nuk ndalen e nuk kërkojnë falje, por edhe vazhdojnë me këtë avaz paturpësisht. Edhe gjykimi i fundit i atij grupi, të vëllezërve tanë shqiptarë, me burgim të përjetshëm është vazhdimësi e kësaj tradite të pacipë.

E cili gjykim sllavo-maqedonas ndaj shqiptarëve që i drejtë dhe real që nga koha kur Tito e formoi Republikën e Maqedonisë, duke grabitur toka andej e këndeje, e deri më tani? Torturat dhe krimet që i bënë sllavo-maqedonasit kundër popullit shqiptar para vitit 2001 ndoshta ishin disi 'pak më lehtë' për t'i kuptuar, për faktin se gjithë shqiptarët andej e këndeje kufijve ishin të persekutuar dhe shënjestër e maltretimeve. Për fat të keq, kjo ishte politika afatgjate sllave që nga koha e Karagjorgjit, Rankoviqit, e deri tek Millosheviqi, që shqiptarëve t'u bëhej presion ashtu që ta lëshojnë vendin e tyre. Le të shkojnë në dashin në Anadoll e në dashin në Atlante, por me rëndësi të mos qëndrojnë në truallin e vet. Mëmëdheu, Shqipëria, e dimë të gjithë se si ka qenë, fatkeqësisht kurrë nuk arritëm t'ia shohim hairin.

Sido që të jetë, pas luftës së vëllezërve tanë atje dhe pas marrëveshjes së nënshkruar në Ohër me 2001, shqiptarët atje nuk është dashur kurrësi të trajtohen në këtë mënyrë. E ngjarjet e fundit, që në fakt janë vetëm vazhdimësi e kësaj dhune shtetërore, po tregojnë se shqiptarët atje i kanë punët keq mu ashtu siç i kishin para marrëveshjes së Ohrit. Vëllezërit tanë atje luftohen, persekutohen, madje ndaj tyre ushtrohet dhunë, gjenocid e masakër dhe atë mu para syve të botës. Kjo nuk është e lehtë për ta kuptuar, por kur e shikojmë se kush po i udhëheq shqiptarët andej e këndeje, atëherë e kuptojmë mirë se marrëveshja e Ohrit nuk ka qenë asgjë më shumë sesa ngjyrë në letër dhe disa foto për konsum politik. Gjithherë sllavët në avancim, andej e këndeje. Gjithmonë shqiptarët të shtypur e të nënçmuar, pa asnjë vlerë, pa asnjë shenjtëri të gjakut, nderit dhe fesë së tyre. Strategji e përsosur sllave për pastrime etnike dhe ortodoksizim të vendit. Flasin për 'radikalë islamik' kurse harrojnë radikalizmin sllavo-ortodoks. Flasin për "ekstremizëm islamik", e harrojnë se Maqedonia është mbushur me kisha e kryqe.

Kësaj belaje i shtohet edhe më shumë zullumi kur dihet se Kosova tashmë është shtet, se Shqipëria nuk është më si në kohën e Enverit, është në NATO, pastaj kandidate për Bashkimin Evropian. Kësaj belaje i shtohet edhe më tepër zullumi kur kihet parasysh se shqiptarët në Maqedoni udhëhiqen kinse nga ata që kanë fituar luftën. O Zot i madh, po kurrë nuk kishim pasur liderë të singertë apo pak burra që japin jetën për popull e vatan! Vërtet ironike kjo marrëzi.

Për veten time kam pritur që BDI-ja menjëherë do të dalë nga qeveria, të gjithë deputetët do ta bojkotojnë parlamentin maqedonas dhe do ta hapin një tjetër në Tetovë. Apo në anën tjetër të

Shkupit. Turp për BDI-në, turp, për qeveritë Edi e Thaçi, turp, një milion herë turp. Nuk kanë madje qoftë edhe pak mëshirë ndaj vëllezërve të tyre. Ndoshta edhe nuk kanë faj, sepse janë të zënë me kampionatin botërorë në Brazil, siç potencoi një qytetar nga Tetova.

Mendoj se nuk ka alternativë tjetër në Maqedoni pos të vazhdojnë protestat derisa sllavi ta ulë kokën dhe jo vetëm kaq, por nuk duhet ndalur derisa shqiptarët të jenë pjesë përbërëse e një konfederate në atë shtet me të drejta të barabarta me sllavët Maqedonas.

Mos u ndalni vëllezërit e mi atje, vazhdoni të protestoni, shpërndajini protestat në gjitha qytetet, natyrisht qetë dhe me kulturë të lartë ashtu si u ka hije shqiptarëve e muslimanëve, mos pritni liderët politik as andej e as këndeje se do t'ua rregullojnë punët, sepse ata vetëm sa i prishin. Ata nuk rregullojnë tjetër pos karrigeve të veta, të cilat po lutem sinqerisht të mos i gëzojnë e mos t'ua shohin hairin.

I bëj thirrje gjithë kombit, gjithë shqiptarëve që i duan shqiptarët dhe kanë gjak shqiptari, në veçanti partitë politike, të bashkohen të gjithë, ta ngrenë zërin së bashku, t'u dalin në ndihmë vëllezërve atje se vërtet po përballen me dhunë dhe situatë të rëndë. Plani sllavo-maqedonas kundër shqiptarëve nuk përfundon me kaq, ata nuk ndalen derisa atje mos të mbetet asnjë shqiptar, derisa t'i boshatisin trojet tona etnike nga ata që flasin dhe mendojnë shqip.

Vëllezër, Shqiptarët në Maqedoni janë në rrezik. Ndaj, a ka kush që u del në ndihmë pos Zotit?!